



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT  
KORÇË  
VENDIM

Nr 17 Datë 09.03.2011

**SHTESE VENDIMI NR. 113 DATE 11.12.2009**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë Korçë «**Shtesë vendimi nr. 113 datë 11.12.2009**», në zbatim të ligjit nr 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", ligjit nr 9869 dt 4.2.2008 «Për huamarrjen e qeverisjes vendore», neni 7, pikat 1 dhe 2 të tij, Udhëzimin nr. 35 dt.5.11.2008 i Ministrisë së Financave "Për zbatimin e ligjit nr. 9869 datë 4.2.2008 Për huamarrjen e qeverisjes vendore" si dhe sipas VKB nr. 113 datë 11.12.2009 "Për miratimin e Huasë Bankare për financimin e disa projekteve të rëndësishme infrastrukturore në qytetin e Korçës", pika 8, (Garanci për kthimin e huasë vendosen të ardhurat e pakushtëzuara të Bashkisë) si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**VENDOSI**

1. Të miratojë si garanci interceptimi i financimit për shlyerjen e kësaj kredie të ardhurat e Bashkisë Korçë (kredimarrësi), si më poshtë :  
Të ardhurat e pakushtëzuara nga buxheti I shtetit të cilat, në rast mospërbushje të detyrimeve të kësaj kredie nga ana e Kredimarrësit, ky I fundit nëpërmjet kësaj marrëveshje dhe pa pasur nevojë për një autorizim tjetër për këtë qëllim, autorizon në mënyrë të përvokueshme sistemin e thesarit të Republikës së Shqipërisë të bëjë lëvrimin automatik të fondeve nga llogaria e Kredimarrësit pranë Sistemit të Thesarit në llogarinë bankare të Kredidhënesit ProCredit Bank me kërkesën e parë me shkrim të bërë për këtë qëllim nga ana e Kredidhënesit. Këto fonde do të kalohen neto nga çdo komision apo tarifë në llogarinë e Kredidhënesit. Datë e pagesës së detyrimit do të konsiderohet data në të cilën llogaria e Kredidhënesit është kredituar nga llogaria e Sistem Thesarit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Kryetari**

**Gjergji PENDAVINJI**